



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.24.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Vushtrrisë në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Ramadan Gashi (Udhëheqës Ekipi), Selvete Foniqi dhe Cyme Hoxhaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	12
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	13
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	25
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	28

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Vushtrisë për vitin 2013, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 ishte ndërmarrë në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrave Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memorandumin e Planifikimit të datës 19/11/2013.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit, dhe auditimin e brendshëm).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga Kryetari i Komunës.

Opinioni

Shtojca I sqaron llojet e ndryshme të Opinioneve të Aplikuara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotë dhe i saktë për arsye se ekzistojnë objekte komunale dhe vetura zyrtare që nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk ishin prezantuar në PVF. Po ashtu, komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime 19,829€. Regjistri i pasurive fikse dhe keq klasifikimi ekonomik i shpenzimeve nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale'), në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

(SNISA 200: Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrole nuk kishin funksionuar në mënyrë efektive në fusha të menaxhimit financiar. Në veçanti ne identifikuam këto mangësi:

- Edhe pse Pasqyrat Vjetore Financiare kishin adresuar shumicën e kërkesave për prezantim, Pasqyrat Vjetore Financiare të paraqitura për auditim kishin një numër lëshimesh dhe pasaktësish. Disa janë ndryshuar në versionin final të Pasqyrat Vjetore Financiare, por menaxhmenti zgjodhi t'i linte disa zëra të pakorrigjuar;
- Vetëm gjysma e rekomandimeve të vitit të kaluar ishin adresuar plotësisht, dhe si rezultat i kësaj, ne kemi përsërit disa nga rekomandimet e mëhershme. Mangësitë dhe dobësitë menaxheriale vazhdojnë të jenë të pranishme edhe më tutje për shkak të neglizhencës për përmirësimet e nevojshme;
- Edhe pse ne arritëm të merrnim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në disa fusha të pasqyrave, vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nxjerr në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë dobësi domethënëse. Kjo veçanërisht ka ndodhur në të hyra; si mungesa e mekanizmave për inkasimin e llogarive të arkëtueshmeve dhe keq klasifikim të shpenzimeve; dhe

- Ndonëse nga ana e auditimit të brendshëm ishin ngritur disa çështje që përshkruajnë dobësitë ekzistuese të sistemeve dhe lidhur me to ishin dhënë rekomandimet përkatëse, menaxhmenti i komunës nuk e kishte marrë në konsiderim trajtimin e tyre me kujdesin e duhur.

Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë si në vijim:

Kryetari duhet të sigurojë:

- Që në procesin e hartimit të Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi i draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe/ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme;
- Që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato;
- Se pengesat (barrierat) në rritjen e shkallës së inkasimit të të hyrave janë identifikuar dhe një plan konkret zbatohet në rritjen e shkallës së inkasimit të të hyrave dhe të adresojë historikun e borxheve;
- Të kryejë një vlerësim të detajuar të procesit të prokurimit dhe kontrollit përkatës për të kuptuar se pse dobësitë e identifikuar vazhdojnë të shfaqen dhe të identifikojë veprimet që duhen zbatuar për t'i mënjanuar barrierat drejt implementimit efektiv të kontrolleve;
- Se menaxhmenti nënshkruan kontrata për stafin e nevojshëm vetëm pasi fondet buxhetore të jenë siguruar, në mënyrë që punonjësit e komunës të paguhet rregullisht dhe në përputhje me kontratat e tyre të punës; dhe
- Se është hartuar një plan veprimi ku përcakton se si do të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga NJAB. Komiteti i auditimit të bëjë një plan pune ku do t'i specifikoj agjendat dhe temat specifike të auditimit që do t'i trajtoj gjatë vitit.

Përgjigja nga Menaxhmenti – auditimi për 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të komunës të përgatis Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurave vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), për PVF-të të dorëzuara në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹ me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotë dhe i saktë për arsye se ekzistojnë objekte komunale dhe vetura zyrtare që nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk ishin prezantuar në PVF. Po ashtu, komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime 19,829€. Regjistri i pasurive fikse dhe keq klasifikimi ekonomik i shpenzimeve nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale'), në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

(SNISA 200: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (SNISA 200). Për më tutje referohu në shtojcën I.

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 19/11/2013, janë identifikuar dy rreziqe domethënëse lidhur me plotësinë në PVF. Ato kishin të bëjnë me prezantimin e Pagesave nga Palët e treta dhe shpалosjen e pasurive. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 - Pagesat nga palët e treta

E gjetura

Gjatë auditimit të ndërmjetëm ne kemi shqyrtuar kontrollet e menaxhmentit dhe proceset shoqëruese për të siguruar prezantimin e drejtë të pagesave nga palët e treta në PVF dhe kemi dhënë këshilla për t'i përmirësuar ato ashtu si duhet. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pagesave nga palët e treta të prezantuara në PVF janë të pasakta. Shumat e identifikuara nuk janë të ndonjë rëndësie materiale.

Rekomandimi 1 Prioriteti i lartë - Kryetari i Komunës duhet të analizojë arsyet për dështimin në paraqitjen e drejtë të Pagesave nga Palët e treta në PVF-të fillestare dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të tyre në vitin 2014.

Rreziku i identifikuar

Çështja 2 - Pasuritë nën pronësi të Komunës nuk janë identifikuar dhe regjistruar në mënyrën e duhur

E gjetura

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive për vitin 2013 dhe vitet paraprake. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që gjendja e pasurive në PVF të jetë e plotë dhe e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të regjistruara në PVF janë materialisht të pasakta. Vlera e prezantuar në PVF nuk është e plotë

dhe e saktë sepse në të nuk janë të përfshira vlera e objekteve shkollore, shtëpitë e shëndetit dhe veturat zyrtare.

Rekomandimi 2 Kryetari i Komunës duhet të identifikojë arsyet si për keq deklarim të vlerës së pasurive, ashtu edhe dështimit në adresimin e këshillës së ZAP. Procese adekuate duhet të vihen në funksion në vitin 2014 për të siguruar se do të paraqitet saktë gjendja e pasurive kapitale dhe jokatitale të komunës.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuara raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me RrF Nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03 / L-048;
- Kërkesën që PVF janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF;
- Kërkesën që PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF);
- Kërkesën që PVF të jenë dorëzuar në gjuhën shqipe dhe serbe;
- Kërkesën që PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe MF gjatë vitit 2013.

Përveç pajtueshmërisë, ne kemi identifikuar disa mangësi në prezantimin e informatave. Në draft pasqyrat financiare ishte e nevojshme që të bëheshin disa korrigjime financiare dhe ne kemi dhënë disa sugjerime për t'u përmirësuar ato.

Pas sugjerimeve tona, disa përmirësime në PVF janë bërë. Megjithatë disa gabime nuk ishin korrigjuar nga ana e komunës, sikurse përmenden në vazhdim:

Çështja 3 - Procesi i përgatitjes së PVF-ve - Prioritet i lartë

E gjetura Në nenin 16- Shënimi 30 dhe Shënimi 31- Shpalosja e pasurive mbi dhe nën 1,000€ nuk ishin paraqitur shumat e plota të pasurive që janë pronë e komunës për shkak se vlera e objekteve shkollore, shtëpitë e shëndetit dhe veturat zyrtare nuk ishin regjistruar.

Neni 12 shënimi 4 - Pagesat nga palët e treta ishin mbivlerësuar për 9,000€. Komuna nuk ka qenë në gjendje të ofroj dëshmi mbi këtë pagesë që e ka prezantuar PVF. Po ashtu, pagesa prej 545€ për GPS të dhuruar nga USAID/DEMI nuk janë prezantuar në PVF.

Shpenzimet kapitale ishin mbivlerësuar për 19,829€, si rezultat i regjistrimeve të shpenzimeve në kodet ekonomike jo adekuate.

Shënimi 28 - Për obligimet e papaguara ishin të nënvlerësuar për 7,355€ pasi që këtë vlerë komuna nuk e kishte prezantuar si obligim.

Rreziku Paraqitja jo e saktë e PVF dhe gabimeve të identifikuar në shumat e regjistruara shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe ka ndikim në saktësinë e kërkesave të ardhshme buxhetore. Aty ku gabimet janë materiale, PVF-të e komunës mund të jenë subjekt i kualifikimit ose theksimit të çështjes.

Rekomandimi 3 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF të vitit 2014 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me cilësinë e informatave dhe kërkesat specifike të raportimit.

2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga Komuna kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e shpenzimeve të komunës;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet Operacionale (performancës);
- Draft Plani dhe Plani Përfundimtar i prokurimit;
- Raportet mbi borxhet; dhe
- Raporti i vetëvlerësimit sipas rregullave të MFK-së.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto, pasi që komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm dhe afatet kohor.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar një plan për adresimin e rekomandimeve nga viti paraprak. Megjithatë, mbi gjysma e rekomandimeve të vitit të kaluar mbeten për t'u adresuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2012 të Komunës kishte rezultuar me 13 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2013, gjashtë rekomandime ishin adresuar plotësisht, pesë ishin adresuar pjesërisht, dhe dy nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Çështja 4 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm gjysma e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse Komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar zbatimin e plotë të rekomandimeve të AP. Dobësitë e vazhdueshme të kontroleve të brendshme në sistemet financiare kyçe kanë treguar që: shkalla e dobët e inkasimit të të hyrave nuk është trajtuar, regjistri i asetëve mbetet i pakompletuar si dhe procesi i përgatitjes së PVF kërkon përmirësime.

Rreziku Dështimi në implementimin e rekomandimeve të AP mund të rezultojë në humbje financiare të komunës dhe jo efektivitet të vazhdueshëm, i cili rezulton në dhënien e shërbimeve jo cilësore, shkallën e ultë të inkasimeve, pasaktësitë në PVF dhe regjistrat financiar përkatës.

Rekomandimi 4 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë një afat kohor konkret dhe sfidues në adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Kryetari i Komunës në mënyrë sistematike.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit.

Ne gjithashtu kemi marrë në konsideratë vetë-vlerësimin e Komunës të ndërmarrë në kuadër të MFP në lidhje me vetë-vlerësimin e KBFP.

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi të hyrat nuk po zbatohen në mënyrë efektive, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë; të hyrat, prokurimi, pagat dhe mëditjet në fushën e arsimit dhe menaxhimi i pasurisë.

4.2 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Ne arritëm të marrim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në disa fusha të pasqyrave financiare, mirëpo vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nxjerr në pah se në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes ekzistojnë dobësi domethënëse.

Çështja 5 - Dobësitë në kontrollet e menaxhmentit të lartë - Prioritet i lartë

- E gjetura** Rishikimi i bërë kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët tek menaxhmenti i lartë lidhur me shpenzimet, të hyrat dhe menaxhimin e pasurisë. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk ka pasur raportime të rregullta dhe të plota prej drejtorive përkatëse tek kryetari i komunës dhe monitorim të mjaftueshëm. Funksonimi i kontrolleve të nivelit të lartë konsiderohet i dobët.
- Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës dhe dëmton kontrollin efektiv buxhetor. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato.
- Rekomandimi 5** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato.

4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për Komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi kundrejt buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	12,601,909	13,149,364	12,243,211	12,046,196	12,365,622
Granti i Qeverisë-Buxheti	11,051,909	11,051,909	10,948,734	10,857,784	11,009,393
Të bartura nga viti paraprak ³	-	440,227	411,489	358,838	305,868
Të hyrat vetanake ⁴	1,550,000	1,550,000	824,543	753,292	859,060
Donacionet Vendore	-	70,622	40,453	60,969	145,758
Donacionet e Jashtme	-	36,606	17,992	15,313	45,543

Buxheti Final është më i lartë se Buxheti Fillestar për 547,455€. Kjo rritje e buxhetit është si rezultat i të Hyrave të bartura nga viti i kaluar (440,227€), dhe Grantet e Donatorëve (107,228€). Komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final gjë që është një përparim i lehtë krahasuar me vitin 2012 (91%) në kushtet e rritjes së shpenzimeve duke reflektuar përmirësimin e infrastrukturës së komunës dhe shërbimeve të ofruara për qytetarët. Megjithatë, ekziston hapësirë për të përmirësuar më tej nivelin e ekzekutimit të buxhetit.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Të hyrat të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual që janë përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive - shpenzimi kundrejt buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	12,601,909	13,149,364	12,243,211	12,046,196	12,365,622
Pagat dhe Mëditjet	7,280,355	7,308,430	7,271,207	7,222,254	6,896,395
Mallrat dhe Shërbimet	1,153,560	1,273,251	1,196,406	1,214,565	1,050,628
Komunalit	271,500	232,600	173,076	189,685	214,660
Subvencionet dhe Transferet	155,000	174,440	163,193	127,753	159,853
Investimet Kapitale	3,741,494	4,160,643	3,439,329	3,291,939	4,044,086

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

Një mospërputhje më e lartë në mes planit dhe shpenzimeve vërehet tek Investimet Kapitale të cilat gjatë vitit 2013 ishin shpenzuar 83% dhe komunalit 75%. Shkaku është dështimi në inkasimin e të hyrave vetjake të cilat ishin planifikuar të shpenzohen si dhe të hyrat e alokuara gjatë muajit nëntor dhe dhjetor nuk mund të shpenzohen për shkak të mbylljes së afatit të zotimeve nga ana e ministrisë së financave.

Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje me 28,075€, Mallra e Shërbime për 119,691€, dhe Investime Kapitale 419,149€, është si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i mëparshëm.

Komuna kishte pranuar edhe grante nga donatorët, të cilat ishin alokuar për të financuar mbështetjen ndaj projekteve të ndryshme. Ekzekutimi i buxhetit në këtë kategori ishte i kënaqshëm.

Asnjë vit të hyrat vetanake nuk shpenzohen në tërësi, si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit, duke pasur parasysh se të hyrat vetanake janë burimi i fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë mbi 417 mijë euro.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të planifikuara dhe të inkasuara - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Të hyrat vetanake	1,550,000	1,550,000	1,213,178	1,157,577	1,240,745€

Buxheti fillestar për të hyrat vetanake nuk pasqyrore pranimet e vitit të kaluar dhe faktorët e tjerë relevant. Nga tabela shihet se realizimi i të hyrave ishte 78%. Në krahasim me vitin paraprak, të hyrat e realizuara ishin për 5% më të larta, por 2% më të ulta se në vitin 2011.

Në anën tjetër, listat e debitorëve ndaj komunës kanë kaluar shifrën prej 2.5 milionë euro, që paraqet një shumë domethënëse për komunën, dhe gjendja e llogarive të arkëtueshme është në rritje të vazhdueshme.

Çështja 6 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Planifikimi i buxhetit, veçmas për investimet kapitale dhe të hyrat vetanake vërehet se nuk ishte analizuar mirë dhe nuk kishte marrë në konsiderim informatat relevante për të ndërtuar një buxhet të qëndrueshëm. Investimet kapitale ishin realizuar në shkallën 83% dhe kishin një përmirësim krahasuar me një vit më parë (78%).
- Rreziku** Planifikimi jo adekuat i të hyrave dhe ekzekutimi i ulët i buxhetit tek investimet kapitale mund të rezultojë në mos realizimin e projekteve kapitale, me ndikim në ofrimin e shërbimeve të duhura për qytetarët.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se procesit të përgatitjes së buxhetit i paraprinë një analizë e cila pasqyron në mënyrë të plotë të gjitha informatat relevante, përfshirë shpenzimet e viteve të kaluara dhe ndryshimet e pritura nëpër vite.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Komuna në përgjithësi kishte vendosur kontrole mbi të hyrat si në procesin e regjistrimit, ashtu edhe atë të raportimit, megjithatë ekziston nevoja për përmirësime të mëtejshme, sidomos në nxjerrjen dhe aplikimin e politikave dhe mekanizmave adekuate në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake nga tatimi në pronë, bizneset, qiratë dhe borxhet tjera si dhe sistemet e faturimit.

Çështja 7 - Mos funksionalizimi i plotë i softuerit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Komuna posedon softuer për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave deri 10€. Ky softuer nuk ishte tërësisht i funksionalizuar sepse zyrat e gjendjes civile nëpër qendra tjera ende nuk kishin filluar të përdorin këtë sistem, por pagesat bëhen në mënyrë manuale.
- Rreziku** Mos funksionalizimi i softuerit rritet rreziku që Komuna nuk do të jetë në gjendje të jap informata të sakta për të gjitha faturimet, inkasimet dhe borxhet në lidhje me të hyrat vetjake.
- Rekomandimi 7** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë funksionalizimin e softuerit për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave.

4.5 Shpenzimet

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Komuna për vitin 2013, kishte planifikuar që përmes prokurimit të shpenzoj 4,160,643€, ndërsa kishte shpenzuar 3,439,329€.

Ne kemi ekzaminuar 97 mostrat që përfshijnë kontratat në prokurim si dhe pagesat dhe kemi vërejtur se janë disa aspekte të procesit të prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Gjetjet tona janë përshkruar në vijim të këtij raporti.

Gjithashtu kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesëm të shpenzimeve. Ne vlerësojmë se në lidhje me këto pagesa nuk ka ndonjë çështje për të theksuar në raport.

Çështja 8 - Shpenzimi i fondeve jo në pajtueshmëri me klasifikimin ekonomik - Prioritet i lartë

E gjetura Nga mostrat e ekzaminuara për investime kapitale, kemi vërejtur se ishin bërë pagesa nga investimet kapitale për mallra dhe shërbime në vlerë prej 19,829€. Këto pagesa kishin të bënin për mirëmbajtje të hapësirave, të cilat ishin regjistruar si shpenzime jo në pajtueshmëri me klasifikimin e kodeve ekonomike.

Rreziku Shpenzimi i mjeteve nga investimet kapitale për mallra dhe shërbime ndikon në mbivlerësimin e investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e mallrave dhe shërbimeve.

Rekomandimi 8 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrollit në këtë fushë, që pagesat të bëhen sipas kodeve adekuate.

Çështja 9 - Mungesa e menaxherit të kontratës - Prioritet i mesëm

E gjetura Kemi vërejtur se te kontrata "Furnizimet për pajisje të teknologjisë informative dhe pajisje për zërim" pagesat në vlerë 43,248€, nuk ishte caktuar menaxher të kontratës i cili do ta mbikëqyrte realizimin e kontratës.

Rreziku Mungesa e menaxherit të kontratës mund të rezultojë me kontrolle të dobëta në zbatimin e kontratës dhe në mos përmbushjen e kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Rekomandimi 9 Kryetari i komunës duhet të siguroj se pas nënshkrimit të kontratës të caktohet menaxheri i kontratës i cili do ta mbikëqyrë realizimin e kontratës që nga fillimi deri në zbatimin final të saj.

4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Për këtë kategori testuam 58 mostra, dhe rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në Ministrinë e Administratës Publike (MAP), si dhe rregullsinë e dosjeve të personelit.

Mangësitë e identifikuara ishin si vijon:

Çështja 10 - Borxhet për punëtorët arsimor për vitin 2013 - Prioritet i lartë

E gjetura Ne kemi vërejtur se gjatë vitit 2013, komuna nuk kishte arritur t'i paguaj 19 mësimdhënës për një muaj. Borxhi ndaj këtyre mësimdhënësve në fund vitit 2013 ishte 6,500€.

Rreziku Mos pagesa e punonjësve të cilët kanë kontratë, vështirëson pozitën materiale të stafit arsimor, dhe po që se pagesat nuk bëhen brenda një periudhe të shkurtër, rrit rrezikun e padive gjyqësore.

Rekomandimi 10 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se kërkesat e stafit vlerësohen me saktësi në bazë vjetore dhe të pasqyrohen në parashtrimet buxhetore. Kontratat duhet të jepen vetëm atëherë kur të sigurohet mundësia e pagesës së pagave.

Çështja 11- Pagesat për mësimdhënësit për mësim jo formal- Prioritet i lartë

E gjetura Te pagesat e bëra për mësimdhënësit e shkollës "Lutfi Musiq" për mësim jo formal për muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2013 në vlerë 2,406€, ne nuk ishim në gjendje të verifikojmë mënyrën e përlllogaritjes se këtyre pagesave për shkak të mungesë të evidencave që tregojnë numrin dhe çmimin e orëve të mbajtura nga mësimdhënësit.

Rreziku Mungesa e evidencave mbi mbajtjen e procesit mësimor për mësim jo formal rritë rrezikun që nga këto të hyra të përfitojnë edhe mësimdhënësit tjerë që nuk kanë qenë të inkuadruar në procesin mësimor.

Rekomandimi 11 Kryetari i Komunës të siguroj mbajtjen e evidencave të mjaftueshme për numrin e orëve të realizuara për secilin mësimdhënës për të parandaluar ndikimet e mëtejme negative në buxhetin e komunës.

4.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për vitin 2013 kishte planifikuar t'i shpenzoj 174,440€, ndërsa kishte shpenzuar 163,193€ apo 94%.

Ne kemi testuar 10 mostra në vlerë 28,256€ nga kjo kategori dhe nuk kemi identifikuar ndonjë mangësi domethënëse.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.6 Pasuritë dhe detyrimet

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Komuna ka bërë progres të mirë në regjistrimin e pasurive krahasuar me vitin paraprak. Në PVF-të e vitit 2012 vlera e pasurisë ishte 36,639,248€, ndërsa fund të vitit 2013 vlera e pasurisë në SIMFK ishte 43,549,366€, por ajo që mbetet të bëjë menaxhmenti, është evidentimi dhe vlerësimi i plotë i gjithë pasurisë së Komunës.

Çështja 12 - Regjistrimet në SIMFK dhe E -Pasuria - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna mban regjistër të pasurive, mirëpo ky regjistër nuk ishte i plotë dhe gjithëpërfshirës i pasurisë, për faktin se disa projekte kapitale, siç janë objektet shkollore, shtëpitë e shëndetit dhe veturat zyrtare nuk ishin regjistruar. Komuna nuk ka arritur të regjistroj të gjitha pasuritë nën 1000€ në sistemin E-pasuria. Ne kemi testuar disa lëndë që nuk ishin përfshirë në regjistrin E-pasuria, si: „Gypa për fikjen e zjarrit në vlerë 2,260€“, „Material për zyrë në Drejtorinë e shëndetësisë vlera 1,870€“ dhe furnizim, transporti dhe montimi i xhamave të shkollave në vlerë 326€, „Furnizime me rafte në vlerë 1,404€“, „Furnizim me fotokopje 900€“, furnizime me klima në vlerë 6,155€.

Rreziku Mungesa e një regjistri gjithëpërfshirës të pasurive, komunës i vështirëson menaxhimin me pasuritë. Për pasojë, kjo rritë rrezikun e nën vlerësimit të pasurisë dhe rrezikun e humbjes dhe tjetërsimit të pasurisë Komunës.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se janë ndërmarr masa që të hartoj një regjistër gjithëpërfshirës, të plotë dhe të saktë të pasurisë, të aplikojë procedura dhe kontrolle të duhura në identifikimin e të gjitha pasurive si dhe të njëjtat t'i regjistroj sipas rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të OB.

4.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Komuna nuk kishte nxjerr dhe aplikuar ndonjë politikë adekuate në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake nga tatimi në pronë, taksa për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejet e ndërtimit.

Çështja 13 - Llogaritë e arkëtueshme -Prioritet i lartë

E gjetura Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të gjitha bazave, përbëjnë shumën e llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 2,504,210€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive kanë të bëjnë me tatimin në pronë prej 2,095,930€, dhe taksa për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit 390,338€ .

Rreziku Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara mund të ndikojë në pamundësinë e Komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve, dhe po ashtu, mund të rezultojë në vështirësi të mëtutjeshme në arkëtimin e të hyrave të ngarkuara.

Rekomandimi 13 Kryetari i Komunës duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

4.6.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Komuna ka arritur të menaxhoj mirë me borxhet. Konkludimet tona të auditimit janë se trajtimi i borxheve dhe kontrollet ndaj tyre përgjithësisht funksionojnë mirë.

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2013 ishte në shumë prej 45,940€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Detyrimet për mallra dhe shërbime 43,210€, ndërsa për komunalit 2,730€.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Komuna ka të themeluar NJAB, i cili ka hartuar planin strategjik dhe vjetor të auditimit për vitin 2013. NJAB për vitin 2013 kishte planifikuar pesë auditime të rregullta, dhe një sipas kërkesë Ad hoc, dhe që të gjitha i kishte kryer gjatë vitit.

Ne kemi vërejtur se NJAB në planin vjetor ka përfshi fushat me rrezik të lartë. Raportet e AB janë të shoqëruara me gjetje dhe rekomandime të vlefshme, që shpalosin dobësitë e kontrolleve kryesore përgjatë të gjitha sistemeve të rëndësishme financiare.

Raportet e kryera janë:

- Drejtoria e prokurimet (Fushëveprim; viti 2013);
- Drejtoria për ekonomi dhe bujqësi (Fushëveprimi; viti 2013);
- Drejtoria e thesarit, buxhet dhe financa (Fushëveprimi; viti 2013);
- Rishikimi i sistemit të KB në komunën e Vushtrrisë për furnizime, faturime, pagesa për derivate të naftës sipas kërkesës së kryetarit (Fushëveprimi; viti 2010/2011);
- Rishikimi i sistemit të KB në drejtorin e buxhetit dhe financave (Fushëveprimi; viti 2013);
- Rishikimi i sistemit të KB në drejtorin e administratës (Fushëveprimi; viti 2013).

Komiteti i auditimit është themeluar me datë 23.02.2010. Ky komitet i auditimit gjatë viti 2013 është takuar katër herë për të shqyrtuar raportet e AB, mirëpo nuk ka nxjerrë konkluzione mbi ndërmarrjen e masave nga menaxhmenti për implementimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna nga NJAB.

Çështja 14 - Mungesa e një planit të veprimit nga menaxhmenti për zbatimin e rekomandimeve të NJAB - Prioritet i lartë

E gjetura Ne kemi vërejtur se menaxhmenti nuk kishte bërë ndonjë plan të veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhënë nga NJAB, për fushat e audituara. Komiteti i Auditimit nuk kishte adresuar çështjet e ngritura nga NJAB dhe nga auditimi i jashtëm.

Rreziku Mos përgatitja e një plan veprimi nga menaxhmenti për adresimin e rekomandimeve të dala nga NJAB-i rritë rrezikun që dobësitë e identifikuara të mos korrigjohen, dhe të përsëritën vazhdimisht rekomandimet e njëjta.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet siguroj se është hartuar një plan veprimi ku përcakton se si do të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga NJAB. Komiteti i Auditimit të bëjë një plan pune ku do t'i specifikoj agjendat dhe temat specifike të auditimit që do t'i trajtoj gjatë vitit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 170519 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2. Pasqyrat Financiare	PVF nuk kanë përfshirë të gjithë informacionin e kërkuar në lidhje me pagesat e palëve të treta.		Pjesërisht	
	Regjistri gjithëpërfshirës i pasurive		Pjesërisht	
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve.		Pjesërisht	
4.4 Te hyrat	Mos realizimit i planit të hyrave të planifikuara.		Pjesërisht	
	Taksa nga mësimi jo formal të pa bazuara në rregullore.	I adresuar		
4.5 Shpenzimet	Vonesat në kryerjen e punimeve dhe dorëzimin e pajisjeve	I adresuar		
	Lidhja e dy kontratave për furnizim me material zyrtar të ngjashëm	I adresuar		
	Formimi i komisioneve për praninë të shërbimeve	I adresuar		
	Mungesa e një regjistri për furnizime	I adresuar		
	Dosjet jo të azhurnuar mirë		Pjesërisht	

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM - KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA
OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

	Akt-emërimi dhe kontratat e punës	I adresuar		
4.6 Pasuritë	Mungesa e dokumentacionit për projektet financuese nga qeverisje qendrore			I pa adresuar
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	Mungesa e një plani të veprimit			I pa adresuar